



QENDRA E TRAJNIMIT "BLITERMENG"

AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE (AKK) PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR EKSPERTË TË SSHP-SË



Prishtinë, 2025

1. PREZANTIMI I MODULIT NË FUSHËN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË (SSHP)

Siguria dhe Shëndeti në Punë përfaqëson një modul bazë që zhvillon aftësitë profesionale për kontrollin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës, të vlefshme për çdo profesion dhe për çdo fazë të procesit të punës. Përmes këtij moduli, punëdhënësit dhe punonjësit pajisen me aftësi të transferueshme që kontribuojnë drejtpërdrejt në mbajtjen e një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm. Analiza dhe parandalimi i rreziqeve në punë shpesh përfshijnë situata të pasigurta, megjithatë ekzistojnë "praktika të mira" të cilat, kur zbatohen në mënyrë korrekte, ndihmojnë të shmangen aksidentet, incidentet dhe dëmtimet e mundshme.

Qendra e Trajnimit BLITERM ENG, përmes njësisë së saj **PCG – Protec Consulting Group**, e bazuar në kërkesat ligjore, respektivisht Rregulloren Nr. 01/2021 mbi Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Licencimin e Kompanive të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, është e licencuar nga MFPT me Licencën Nr. 05/2021. Qendra është gjithashtu **e akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të Kosovës për dy programe trajnuese: "Instruktor në vendin e punës" dhe "Ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë"**. BLITERM ENG ofron programe të standardizuara dhe të përditësuara, të përshtatshme për aplikim praktik në ambientet e punës, të harmonizuara me legjislacionin vendor, me standardet evropiane dhe me standardet ndërkombëtare ISO, në veçanti **ISO 45001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**.

Në përputhje me Rregulloren (MPMS) Nr. 01/2021, janë përcaktuar edhe sektorët me rrezikshmëri të lartë, përfshirë:

- Ndërtimtarinë
- Prodhimtarinë
- Minierat
- Transportin
- Bujaqësinë dhe Pylltarinë

Qëllimi i programit është të përgatisë ekspertë të SSHP-së dhe të edukojë inxhinierë të fushës për nevojat e organizatave, institucioneve, agjencive dhe industrive, në përputhje me praktikën më të avancuar ndërkombëtare. Kjo përmbush një kërkesë të domosdoshme për zhvillim dhe avancim të vazhdueshëm të kuadrove të kualifikuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Qendra e Trajnimit përbëhet nga një ekip profesionistësh që operojnë në terren sipas metodologjive të standardizuara, me veprimtari në:

- aktivitetet profesionale shkencore dhe teknike,
- aktivitetet organizative,
- analizën dhe vlerësimin e rrezikut dhe dëmit,
- zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë në institucione.

Qendra ka potencialet e saj në organizimin e trajnimeve dhe këshillimeve në fushën e SSHP-së, duke orientuar dhe përcaktuar kushtet e sjelljes në punë dhe duke ndihmuar në krijimin, përshtatjen dhe hartimin e raporteve e rregulloreve në përputhje me legjislacionin vendor të harmonizuar me direktivat evropiane dhe Ligjeve në Republikën e Kosovës.



Analiza e rrezikut mbetet një element kyç: ajo duhet të marrë parasysh të gjitha rreziqet dhe situatat e pasigurta, duke garantuar se reduktimi i një rreziku nuk shkakton rritjen e një tjetri. Vetëm përmes një qasjeje të balancuar mund të sigurohet reduktimi i ekspozimit të punëtorëve dhe të palëve të tjera të pranishme (vizitorë, kontraktorë, kalimtarë të rastit) ndaj rreziqeve të mundshme.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

TITULLI I PROGRAMIT	Programi i trajnimit për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP) Akredituar nga AKK.
KËRKESAT MINIMALE PËR ARSIMIN E MËPARSHËM	Për të arritur këtë kualifikim, kandidatët duhet të kenë një diplomë universitare në shkencat teknike dhe të paktën një vit përvojë pune në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë ose dy vite përvojë të përgjithshme pune. Alternative, kandidatët mund të kenë një diplomë universitare në biologji, kimi, fizikë, juridik, psikologji, mjekësi ose fusha të ngjashme, së bashku me tre vite përvojë pune në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë ose pesë vite përvojë të përgjithshme pune.
QËLLIMI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT	Ky program synon të pajisë kandidatët me njohuri dhe aftësi profesionale për: - Identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës; - Zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve; - Aftësimin e ekspertëve për të punuar si të punësuar të brendshëm në kompani ose si ofrues të jashtëm të shërbimeve të SSHP-së; - Sigurimin e kompetencave për të vepruar në industri me risk të ulët dhe të lartë; - Mbështetjen e shërbimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë në përputhje me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare.
KOHËZGJATJA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT	Programi ka një kohëzgjatje prej 160 orësh mësimore gjithsej, të cilat përbëhen nga orë teori, praktikë, vlerësim dhe vetë-studim.
FORMA E TRAJNIMIT	Prania fizike në trajnim, me sesione prej 5 - 6 orësh mësimore.
FLEKSIBILITETI	Qendra e trajnimit ka të drejtë të bëjë deri në $\pm 10\%$ ndryshime në numrin e orëve të kontaktit për pjesën teorike, me kusht që të mbulohen të gjitha temat e përcaktuara në kurrikulën e trajnimit.
DOKUMENTI PËRFUNDIMTAR ARSIMOR	Konfirmim me shkrim për vijueshmërinë dhe përfundimin e trajnimit, i lëshuar nga Qendra e Trajnimit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe i verifikuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të Kosovës për akreditim.
MUNDËSITË PËR ARSIMIM TË MËTUTJESHËM	Pas përfundimit të suksesshëm, Eksperti i SSHP-së mund të avancojë në Certifikimin për Trajner të SSHP-së , në përputhje me kërkesat e Rregullores Nr. 01/2021 të MPMS.
TRAJNERËT E QENDRËS	Trajnerët kanë Certifikatë të vlefshme të Trajnerit , në përputhje



	me Rregulloren (MPMS) Nr. 01/2021 mbi Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe Kompanitë e Trajnimit.
REFERENCA LIGJORE	<i>Rregullore (MPMS) Nr. 01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.</i>

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT PËR EKSPERTË TË SSHP-SË

Ky program është strukturuar mbi fusha të përcaktuara qartë, të bazuara në tema shumëdimensionale që çdo ekspert i ardhshëm i SSHP-së duhet t'i njohë, t'i zotërojë dhe t'i praktikojë gjatë trajnimit.

Programi ka natyrë komplekse dhe realizimi i tij nënkupton një proces më afatgjatë, ku secili kandidat do të ketë mundësi të përfshihet në një transformim profesional e personal, duke ndjekur vizionin e arsimit të integruar dhe duke reflektuar këto aftësi në praktikën institucionale.

Tabela 1. Ndarja e moduleve sipas orëve dhe pikëve akredituese ECVET

NR.R.	MODULET	KOHËZGJATJA DHE KREDITË	
1	Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar për SSHP	20 orë mësimore	1 ECVET kredi
2	Vlerësimi i riskut për pozitat e punës dhe faktorët e rrezikut	40 orë mësimore	2 ECVET kredi
3	Masat Parandaluese/Mbrojtëse	20 orë mësimore	1 ECVET kredi
4	Informimi i të punësuarve	20 orë mësimore	1 ECVET kredi
5	Trajnimi i të punësuarve	40 orë mësimore	2 ECVET kredi
6	Monitorimi dhe mbikëqyrja	20 orë mësimore	1 ECVET kredi
Gjithsej:		160 orë mësimore	8 ECVET kredi

Vërejtje: Në kuadër të programit të trajnimit për Ekspertë të SSHP-së do të përdoren literaturë të përditësuara, makete dhe shembuj praktik, analiza dhe studime profesionale.

Literaturat dhe materialet do të rifreskohen sa herë të jetë e nevojshme, përfshirë edhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi.



4. OFERTA FINANCIARE

Përfshirja e trajnimit si bazë e ofertës financiare

Çmimi i përgjithshëm për zhvillimin e trajnimit të përshkruar më lart, në kuadër të implementimit të programit nga fusha e SSHP-së, është paraqitur sipas kërkesës. Ky çmim përfshin tërësisht angazhimet e nevojshme për realizimin e programit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Në çmim janë të mbuluara:

- Shërbimet e trajnerëve të licencuar dhe me përvojë në fushën përkatëse;
- Materialet shpenzuese të nevojshme gjatë procesit të trajnimit;
- Materialet zhvilluese të programit, të përgatitura sipas standardeve dhe kushteve akredituese;
- Koordinimi dhe menaxhimi i përgjithshëm i procesit të implementimit të trajnimit.

Oferta bazë e zhvillimit të programit trajnues 160 orë sipas AKK:		
M1: Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar për SSHP	1.00	€ 450.00
M2: Vlerësimi i riskut për pozitat e punës dhe faktorët e rrezikut		
M3: Masat Parandaluese/Mbrojtëse		
M4: Informimi i të punësuarve		
M5: Trajnimi i të punësuarve		
M6: Monitorimi dhe mbikëqyrja		
TOTAL PËR KANDIDAT:		450.00 €

Shënim referues:

Për grupet e interesit të organizuara dhe ato institucionale, qendra e trajnimit ofron zbritje të veçantë, ku çmimi për secilin kandidat ulet nga **450 € në 350 €** për programin e plotë.

Sqarime shtesë:

Kandidatët janë të obliguar të mbulojnë vetë shpenzimet e udhëtimit dhe të shujtave ditore gjatë periudhës së trajnimit.

Në çmim nuk përfshihet tarifa shtesë prej **50 €**, e cila ka të bëjë me testimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për validim pranë **Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK)**.